

Monitori i të drejtave pronësore 2021 – 2025

JANAR 2021 – DHJETOR 2025

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) është i mandatuar për t'i mbështetur institucionet e Kosovës në zbatimin e politikave dhe kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat pronësore dhe banesore¹. Në suazat e këtyre përpjekjeve, OSBE përpilon Monitorin e të drejtave pronësore (MDP)², që është një instrument monitorimi i ideuar për përcjelljen e trendeve dhe zhvillimeve me ndikim në të drejtat pronësore dhe banesore të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, personave të zhvendosur (PZH), si dhe pjesëtarëve të komunitetit shumicë në zonat ku këta të fundit përbëjnë pakicë numerike.

MDP është botim gjashtëmujor që përmban gjetjet e monitoruesve të OSBE-së në terren në nivel vendi në fushën e të drejtave pronësore dhe banesore³. Ai shërben si instrument përmes të cilit OSBE monitoron dhe raporton për trendet dhe zhvillimet e reja dhe i këshillon institucionet në lidhje me respektimin e legjislacionit përkatës, standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, si edhe shërben si mekanizëm për përcjelljen e përparimit të arritur dhe adresimin e mangësive të mbetura. Përmes këtij instrumenti, OSBE synon t'u ndihmojë institucioneve përgjegjëse që t'i adresojnë hendeqet e evidentuara në zbatimin e legjislacionit dhe ekzekutimin e vendimeve. Ky botim mbulon periudhën pesëvjeçare 2021–2025.

PËRMBLEDHJE

E drejta në pronë është gurthemel i të drejtave të njeriut dhe mbrohet me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut⁴ dhe me kornizën ligjore të Kosovës⁵. Ky edicion i MDP-së paraqet një pasqyrë të përmbledhur të gjendjes së të drejtave pronësore dhe banesore në Kosovë, me fokus në situatën e grupeve në pozitë të cenueshme, përfshirë komunitetet joshumicë dhe PZH-të, dhe konstaton se, përkundër përparimit të dukshëm në fusha si banimi social dhe pjesëmarrja gjithëpërfshirëse në planifikim hapësinor, ngelen sfida të konsiderueshme sa i përket sigurimit të qasjes së barabartë të të gjitha komuniteteve në të drejtat dhe shërbimet pronësore. Përfundimet kryesore të këtij MDP sugjerojnë që institucionet përgjegjëse duhet të:

- harmonizojnë proceset e shpronësimit me standardet ligjore dhe ndërkombëtare;
- sigurojnë ekzekutimin e masave kundër uzurpimit të kundërligjshëm të pronës;
- rrisin kapacitetet e komunave për legalizim të ndërtimeve pa leje;
- vazhdojnë pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në planifikimin hapësinor;
- përmirësojnë bashkërendimin ndërmjet institucioneve qeveritare dhe komunale.

Të dhënat për këtë MDP janë siguruar nga monitorimi në terren në nivel vendi gjatë periudhës kohore janar 2021 - dhjetor 2025, si dhe janë plotësuar me informacione të ofruara nga zyrtarë komunalë të urbanizmit, kadastrës dhe zyrave ligjore në të 38 komunat e vendit. Si kufizim metodologjik, duhet theksuar se institucionet nuk ofrojnë gjithmonë të dhëna të kategorizuara sipas komunitetit dhe/ose gjinisë. Në shumë raste, stafit në terren të OSBE-së i është dashur të bëjë përpjekje shtesë për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave të përfshira në këtë edicion të MDP-së.

NUMRI I RASTEVE PËR PERIUDHËN E RAPORTIMIT

SHPRONËSIM	738
UZURPIM I KUNDËRLIGJSHËM	13
BANIM SOCIAL	358
KËRKESA PËR LEGALIZIM TË NDËRTIMEVE PA LEJE	35602
PLANIFIKIM HAPËSINOR	82
NDARJA E TOKËS KOMUNALE	0
TATIMI MBI PRONËN E PALUAJTSHME	0

¹ Vendimi nr. 305 i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, dt. 01.07.1999, i disponueshëm te: <https://www.osce.org/pc/28795>, qasur më 25 gusht 2025.

² Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Monitori i të Drejtave Pronësore, ed. 13 (14 prill 2026), i disponueshëm te: [Property Rights Monitor - 13th edition | OSCE Mission in Kosovo](https://www.osce.org/pc/28795).

³ Informatat e paraqitura në këtë botim të MDP-së ngërthejnë vetëm rastet ku ekipet në terren të OSBE-së kanë pasur qasje në informacion.

⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 1, Protokolli 1. https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_ENG

⁵ Kushtetuta e Kosovës, neni 46. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

ZHVILLIMET KRYESORE SIPAS FUSHAVE

SHPRONËSIMI

Përkufizim: Shpronësimi paraqet një akt të autorizuar ligjërisht nga autoritetet për heqjen e të drejtave të pronësisë nga pronari i një prone publike ose private, me qëllim të realizimit të një interesi publik, sipas kushteve të përcaktuara me ligj⁶, përfshirë ofrimin e kompensimit për pronarët e prekur. Ky edicion i MDP-së pasqyron numrin e shpronësimeve të pronave të grupeve në pozitë të cenueshme, me fokus të veçantë te komunitetet joshumicë dhe PZH-të.


Të dhënat: Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të rasteve në të cilat pronat që u përkasin komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve kanë qenë objekt shpronësimi. Ato janë kategorizuar sipas rajonit dhe vitit, për pesë rajone: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ).

Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025 janë evidentuar 738 raste të shpronësimit të pronave të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve.

Numri më i madh i rasteve është evidentuar në rajonin e Mitrovicës, pasuar nga rajonet e Pejës, Gjilanit dhe Prishtinës, kurse në rajonin e Prizrenit është evidentuar vetëm një rast.

Në raste të caktuara, përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë i kanë kundërshtuar vendimet për shpronësim. Për shembull, në vitin 2023, 58 pronarë serbë të Kosovës nga rajoni i Mitrovicës e kontestuan në gjykatë ligjshmërinë e vendimeve për shpronësim. Gjykata njohu të drejtat e gjashtë prej këtyre pronarëve, duke i rrëzuar vendimet për shpronësim. Si rezultat, qeveria i hoqi këto gjashtë (6) prona nga procesi i shpronësimit.

Rastet sipas rajonit dhe vitit



UZURPIMI I KUNDËRLIGJSHËM

Përkufizim: Uzurpimi i kundërligjshëm i pronës së paluajtshme është vepër penale sipas nenit 320 të Kodit penal të Kosovës⁷. Pronat që u përkasin grupeve në pozitë të cenueshme, veçanërisht pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve, kanë qenë shpesh objekt i uzurpimit të kundërligjshëm. Ky edicion i MDP-së pasqyron numrin e uzurpimeve të kundërligjshme të pronës që kanë ndodhur gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Të dhënat: Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të rasteve të uzurpimit të kundërligjshëm të pronës së komuniteteve joshumicë, PZH-ve dhe pjesëtarëve të komunitetit shumicë që jetojnë në zona ku këta të fundit përbëjnë pakicë numerike. Ato janë kategorizuar sipas rajonit dhe vitit, për pesë rajone: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ).

Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025 janë evidentuar 13 raste të uzurpimit të kundërligjshëm të pronës. Prej tyre, 12 kanë prekur prona në pronësi të serbëve të Kosovës, ndërsa një rast kishte të bënte me pronën e një shqiptari të Kosovës. Numri më i madh i uzurpimeve të


⁶ Ligji nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-205 dhe Ligjit nr. 04/L-115). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2636&langid=2>

⁷ Kodi penal nr. 06/L-074 i Kosovës (me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 08/L-188). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413&langid=2>

kundërligjshme është evidentuar në rajonin e Mitrovicës, pasuar nga rajonet e Gjilanit, Pejës dhe Prishtinës, kurse në rajonin e Prizrenit nuk u regjistrua asnjë rast i uzurpimit të kundërligjshëm gjatë kësaj periudhe.

Edhe pse nuk vërehet ndonjë trend i qartë i rritjes së uzurpimit të kundërligjshëm të pronave, dhe numri i përgjithshëm i rasteve të tilla nuk është i madh, vazhdimësia e kësaj dukurie është brengosëse. Duke qenë se e drejta në pronë është e drejtë themelore e njeriut, autoritetet publike duhet të sigurojnë që çdo person të ketë qasje në pronën e vet dhe ta gëzojë atë në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh se, sipas monitorimit të OSBE-së, rajonet e Mitrovicës dhe Gjilanit janë prekur më shumë nga kjo dukuri, autoritetet publike duhet t’u japin përparësi përpjekjeve për ta përmirësuar gjendjen në këto rajone.



BANIMI SOCIAL


Përkufizim: Banimi social është detyrim i autoriteteve për t’i adresuar nevojat për strehim të personave dhe familjeve që nuk mund të përballojnë një standard adekuat jetese⁸. Ky edicion i MDP-së pasqyron numrin e rasteve në të cilat pjesëtarë të grupeve në pozitë të cënueshme, si komunitetet joshumicë, PZH-të dhe gratë, kanë përfituar banim social.

Të dhënat: Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të rasteve në të cilat persona /familje në pozitë të cënueshme kanë përfituar banim social, të kategorizuara sipas rajonit dhe vitit, për pesë rajone: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ).

Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025, 358 persona/familje kanë përfituar nga programet e banimit social. Siç paraqitet në tabelë, rajoni i Prishtinës prin me numrin më të madh të përfituesve të banimit social, me gjithsej 177 persona/familje. Këtu përfshihen dhjetë shqiptarë të Kosovës (përfshirë tri gra), 100 serbë të Kosovës (prej të cilëve 17 janë PZH) dhe 50 romë të Kosovës.

Në rajonin e Prizrenit, nga programet e banimit social kanë përfituar 68 shqiptarë të Kosovës, 40 boshnjakë të Kosovës dhe një person/familje ashkali e Kosovës, duke kapur shifrën 109.

Në rajonin e Gjilanit, përfituese ishin 36 gra shqiptare vetushqyese të Kosovës. Në rajonin e Mitrovicës, 34 serbë të Kosovës dhe dy romë të Kosovës kanë përfituar banim social gjatë periudhës për të cilën raportohet.



⁸ Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

Sipas informatave që u janë ofruar ekipeve në terren të OSBE-së, numri i familjeve që kanë kërkuar mbështetje në rajonin e Pejës ka qenë i ulët. Për këtë arsye, komuna ka vendosur t'i mbështesë këto familje përmes pagesës së qirasë.

Në përgjithësi, monitorimi i OSBE-së evidenton për përparim të qëndrueshëm dhe gradual në përmbushjen e detyrimit të institucioneve të Kosovës për t'u ofruar banim social personave dhe familjeve në nevojë. Veçanërisht inkurajues është fakti se, krahas PZH-ve dhe grave, nga këto programe kanë përfituar edhe pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, sidomos komuniteteve rom, boshnjak dhe ashkali të Kosovës.

KËRKESA PËR LEGALIZIM TË NDËRTIMEVE PA LEJE

Përkufizim: Legalizimi është proces i drejtuar nga autoritetet për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Sipas Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje⁹, objekti i ndërtuar në parcelën e një pale tjetër nuk mund të legalizohet derisa të vërtetohet pronësia ose e drejta për shfrytëzim të së njëjtës. Ky ligj synon të mbrojë grupet në pozitë të cënueshme, përfshirë komunitetet joshumicë dhe/ose personat e zhvendosur (PZH), nga uzurpimi i kundërligjshëm i parcelave të tyre. Ky edicion i MDP-së pasqyron numrin e kërkesave për legalizim, si dhe numrin e certifikatave të legalizimit të lëshuara për ndërtimet pa leje.

Të dhënat: Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të kërkesave për legalizim të ndërtimeve pa leje, të kategorizuara sipas rajonit dhe vitit, në pesë rajone: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ).


Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025, në nivel vendi, komunat kanë pranuar 35,602 kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje dhe kanë lëshuar 15,467 certifikata legalizimi. Prej këtij numri, gjithsej 120 certifikata legalizimi u janë lëshuar pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, përfshirë 24 serbë të Kosovës, 28 ashkali të Kosovës, pesë turq të Kosovës, dy boshnjakë të Kosovës dhe një rom i Kosovës.

Në përgjithësi, numri i kërkesave të pranuar dhe i certifikatave të legalizimit të lëshuara ka qenë relativisht i ngjashëm në të pesë rajonet, me përjashtim të rajonit të Prizrenit, ku procesi ka ecur me ritëm pak më të ngadalshëm.

Nga numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara për legalizim, deri më tani janë shqyrtuar dhe vendosur më pak se gjysma. Kjo tregon se komunat janë përballur me sfida në trajtimin e vëllimit të madh të rasteve të legalizimit.

Nga ana tjetër, certifikatat e legalizimit të lëshuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të numrit të përgjithshëm të certifikatave të lëshuara. Megjithatë, gjatë monitorimit, OSBE-ja nuk ka pranuar ankesa nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve lidhur me procesin e legalizimit. Duke qenë se procesi është ende në vazhdim, mund të pritet që në periudhën në vijim të rritet edhe numri i pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë që përfitojnë nga kjo mundësi ligjore.

⁹ Ligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje (me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 08/L-184). <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17767>



PLANIFIKIMI HAPËSINOR


Përkufizim: Planifikimi hapësinor është instrument i politikave publike për rregullimin e hapësirës publike në të gjitha nivelet¹⁰. Pjesëmarrja në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor është thelbësore jo vetëm për vlerësimin dhe shprehjen e nevojave të komuniteteve, por edhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave individuale pronësore. Ky edicion i MDP-së pasqyron numrin e proceseve të planifikimit hapësinor në kuadër të të cilave janë marrë parasysh nevojat e grupeve në pozitë të cenueshme, komuniteteve joshumicë, grave dhe/ose rinisë.

Të dhënat: Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të proceseve të planifikimit hapësinor në të cilat kanë marrë pjesë komunitetet joshumicë, gratë dhe të rinjtë dhe kanë pasur mundësinë t'i shprehin shqetësimet lidhur me pronën dhe nevojat për zhvillim urban/rural. Ato janë kategorizuar sipas rajonit dhe vitit, për pesë rajone: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ).

Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025, pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, gratë dhe të rinjtë kanë marrë pjesë në gjithsej 82 procese të planifikimit hapësinor.

Pjesëmarrja në procese të planifikimit hapësinor u mundëson komuniteteve joshumicë, grave dhe të rinjtë t'i shprehin shqetësimet lidhur me të drejtat e tyre pronësore, si dhe nevojat për zhvillim urban dhe rural. Kjo pjesëmarrje është thelbësore për transparencë, qeverisje të mirë, vendimmarrje gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore individuale dhe të komuniteteve.

Monitorimi i OSBE-së shpalosë se rajonet e Prizrenit, Pejës dhe Gjilanit prijnë me këtë proces, ndërkohë që rajoni i Mitrovicës ka mbetur mbrapa. Komunitat e rajonit të Prishtinës i kanë përfunduar dokumentet e tyre të planifikimit hapësinor në periudhën e mëparshme të raportimit, rrjedhimisht gjatë kësaj periudhe janë mbajtur vetëm dy aktivitete të pjesëmarrjes publike në këtë rajon.



¹⁰ Ligji nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

NDARJA E TOKËS KOMUNALE

Përkufizim: Ndarja e tokës komunale për projekte që lidhen me kthimin është procedurë ose iniciativë e ndërmarrë nga autoritetet për të krijuar kushte për kthimin e PZH-ve.¹¹

Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025, komunat nuk kanë ndarë tokë për projekte që lidhen me kthimin. Sipas monitorimit të OSBE-së, gjatë kësaj periudhe komunat nuk kanë pranuar asnjë kërkesë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim ose nga institucione/organizata të tjera për të tokës komunale për projekte që lidhen me kthimin dhe, si rrjedhim, nuk është evidentuar asnjë rast i ndarjes së tokës.

TATIMI MBI PRONËN E PALUAJTSHME

Përkufizim: Tatimi mbi pronën e paluajtshme është pagesë e detyrueshme që parashihet dhe zbatohet nga autoritetet për pronësinë ose të drejtën e shfrytëzimit të pronave banesore, bujqësore dhe komerciale¹². Megjithatë, në disa raste, pronat që u përkasin pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë kanë qenë ose vazhdojnë të jenë të uzurpuara në mënyrë të kundërligjshme dhe pronarët vazhdojnë ta bartin barrën e detyrimit tatimor përkundër faktit se nuk gëzojnë posedim fizik të këtyre pronave. Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme e ka adresuar këtë çështje duke paraparë lirimin e këtyre pronarëve nga detyrimi tatimor. Ky lirim është në fuqi që nga viti 2018.

Periudha e raportimit: Gjatë periudhës janar 2021 – dhjetor 2025, palët e prekura nuk kanë parashtruar asnjë kërkesë për lirim nga tatimi. Ndonëse lirimi nga detyrimi i tatimit në pronë përbën lehtësirë për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe PZH-të pronat e të cilëve kanë qenë ose vazhdojnë të jenë të uzurpuara në mënyrë të kundërligjshme, monitorimi i OSBE-së nuk ka evidentuar asnjë rast të parashtruar në komuna për këtë lloj lirimi.

ZHVILLIMET DHE PËRFUNDIMET KRYESORE

Kjo pasqyrë e përmbledhur evidenton si përparimin e arritur, ashtu edhe sfidat e vazhdueshme në mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe banesore të grupeve në pozitë të cenueshme. Ndonëse janë bërë përpjekje në një sërë fushash, nevojitet angazhim i mëtejshëm për të siguruar barazi dhe qasje për të gjitha komunitetet. Nismat në fushën e banimit social përbëjnë zhvillim pozitiv që ka rezultuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për qindra familje dhe gra në pozitë të cenueshme. Në anën tjetër, ndonëse procedurat e shpronësimit në përgjithësi janë zhvilluar pa pengesa të mëdha, rastet në rajonin e Mitrovicës kanë ngritur shqetësime lidhur me ligjshmërinë dhe legjitimitetin e procesit. Po kështu, uzurpimi i kundërligjshëm i pronës, veçanërisht në rajonin e Mitrovicës, mbetet shqetësim që kërkon masa të synuara institucionale dhe ligjore. Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje ka ecur me ritëm të ngadaltë, meqë nga 36,000 kërkesa të parashtruara, për më shumë se gjysmën ende nuk është vendosur për certifikim. Ndërkohë, në fushën e planifikimit hapësinor janë shënuar trende pozitive, me pjesëmarrje aktive të komuniteteve joshumicë, grave dhe të rinjve në proceset publike. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare nuk është evidentuar asnjë rast i ndarjes së tokës komunale për projekte të kthimit. Po kështu, ndonëse ligji parasheh lirimin nga detyrimet tatimore për pronat e uzurpuara, niveli i ulët i informimit publik vazhdon ta kufizojë shfrytëzimin e kësaj mundësie nga personat që kanë të drejtë të përfitojnë prej saj.

Për adresimin e këtyre mangësive nevojitet vullnet më i fortë politik, bashkërendim më i mirë institucional, ndarje e mjaftueshme e resurseve dhe angazhim i vazhdueshëm i komuniteteve. Për të promovuar një sistem më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të barabartë të mbrojtjes së të drejtave pronësore dhe banesore në Kosovë, OSBE u rekomandon institucioneve të marrin masat në vijim:

¹¹ Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18917>

¹² Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme (me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 08/L-224). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15984>

Qeveria dhe komunat: Të sigurojnë që të gjitha proceset e shpronësimit të zhvillohen në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet ndërkombëtare, veçanërisht në rastet që prekin komunitetet joshumicë dhe PZH-të, duke garantuar njëherazi kompensim të drejtë.

Institucionet e zbatimit të ligjit: Të forcojnë mekanizmat për trajtimin e uzurpimit të kundërligjshëm të pronës, me fokus në zonat me numër më të madh të rasteve, si rajoni i Mitrovicës, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e komuniteteve në pozitë të cenueshme dhe të përshpejtohet zgjidhja gjyqësore e rasteve të pazgjidhura të shpronësimit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe zyrtarët përkatës komunalë: Të zgjerojnë programet e banimit social gjithëpërfshirës dhe të forcojnë kapacitetet komunale për përshpejtimin e procedurave të legalizimit me qëllim të tejkalimit të pengesave strukturore, si dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e vazhdueshme aktive të komuniteteve joshumicë, grave dhe të rinjve në planifikim hapësinor.

Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe zyrtarët përkatës komunalë: Të vlerësojnë në nivel qeveritar arsyet e kërkesës së ulët për ndarje të tokës komunale për projekte që lidhen me kthimin, me qëllim të forcimit të mbështetjes për kthimin e PZH-ve.

Ministria e Financave dhe Transfereve dhe zyrtarët përkatës komunalë: Të promovojnë dhe funksionalizojnë lirimin nga tatimi mbi pronën e paluajjtshme përmes fushatave të vetëdijesimit të komunitetet joshumicë dhe PZH-të, pronat e të cilëve janë të uzurpuara në mënyrë të kundërligjshme.